



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prof. Nr.
DPK-1741	03-02/802/17
Nr. I faq. Nr. pages	Date Date
	13.03.2018
PRISHTINE	

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	13.03.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-682/18
PËR/ZA/TO:	znj. Valbona HASHANI Drejtore i zyrë së Prokurimit Agjencia Katastrale e Kosovës
CC:	z. Murat Meha KryeShef Ekzekutiv në Agjencia Katastrale e Kosovës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Aerofotografimi i territorit të Republikës së Kosovës” me nr. të prokurimit 60100/18/1045/211, nr. të brendshëm 60100/18/003/221.

E nderua, znj. Hashani,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Aerofotografimi i territorit të Republikës së Kosovës”** me nr. të prokurimit 60100/18/1045/211, nr. të brendshëm 60100/18/003/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Aerofotografimi i territorit të Republikës së Kosovës”** me nr. të prokurimit 60100/18/1045/211, nr. të brendshëm 60100/18/003/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 07 mars 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-682/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Aerofotografimi i territorit të Republikës së Kosovës”** me nr. të prokurimit 60100/18/1045/211, nr. të brendshëm 60100/18/003/221, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Agjencia Katastrale e Kosovës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë të llojit shërbime, me vlerë të madhe. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: *“Përvojë relevante në zbatimin e projekteve të ngjashme: Të paktën një projekt (kontratë) të ngjashme të përfunduar (prodhimi ortofoto ose prodhimi i hartave fotogrametrike) në 3 vitet e fundit. Projektet e përfunduara në 3 vitet e fundit (2015, 2016 dhe 2017) duhet të kenë vlerën e kontratës të barasvleshme me shumën e paraparë”,* ndërsa tek dëshmia e kërkuara dokumentare është kërkuar: *“Një listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tre vjeçare (2015, 2016, 2017), duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën,*

pranuesin si dhe një (1)referencë apo raporte të pranimit të shërbimeve apo raporte të pranimit të shërbimeve për realizimin me sukses të shërbimeve për realizimin me sukses, të barasvlershme me ofertën financiare të ofertuesit për këtë aktivitet të prokurimit”, kërkesë kjo për të cilën Agjencia gjithashtu konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69 .

Bazuar në legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26.8 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkoj si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, duhet të ceket vlera minimale e kontratave dhe referencave të realizuara ne 3 (tri) vitet e fundit, e jo siç ka vepruar në rastin konkret autoriteti kontraktues duke mos cekur fare vlerën minimale të shërbimeve në 3 (tri) vitet e fundit.

Andaj, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se kërkesa e specifikuar ne nenin 9.1 lidhur me nenin 9.2 në FTD, është në kundërshtim me nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, si dhe me nenin 26 paragrafi 8 pika 4 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, ku thuhet: *Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë kufizimin ligjor një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.*

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27 dosja e tenderit dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Agjencia pas trajtimit të dokumentacionit për tenderin me titull: ***“Aerofotografimi i territorit të Republikës së Kosovës” me nr. të prokurimit 60100/18/1045/211, nr. të brendshëm 60100/18/003/221,*** ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !